



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË
KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË
LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË
ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 18.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëemërore për këshillat bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Partia e Gjellbër, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin Qendror të



Nr . 538 i vendimit

Data 18.05.2017 e vendimit

Ora 12:00 e vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillat bashkiak Kolonjë, Tropojë, Kurbin, Përmet, Maliq, Pogradec, Selenicë, Devoll, Ura Vajgurore, Malësi e Madhe, Gramsh, Librazhd dhe Prrenjas si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumëmemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përgjigje të shkresës, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në KQZ, verifikim i gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak Kolonjë, Tropojë, Kurbin, Përmet, Maliq, Pogradec, Selenicë, Devoll, Ura Vajgurore, Malësi e Madhe, Gramsh, Librazhd dhe Prrenjas, sipas të cilës rezulton:

FLAMUR NASUFI kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjellbër me numër rendor 05, Bashkia Gramsh. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, rezulton të jetë dënuar me vendimin gjyqësor nr. 384, datë 22.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, me 8 (tetë) muaj burgim bazuar në nenin 406 të K.Pr.Penale, për veprën penale "Ngacmim seksual", parashikuar nga neni 108/a/1 i Kodit Penal.

ERJON NOKA kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjellbër me numër rendor 16, Bashkia Kurbin nuk ka deklaruar asnjë dënim të formës së prerë apo kundravajtje penale. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, me vendimin nr.497, datë 18.11.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë e deklaroi fajtor për veprën penale "Drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 të K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 4 (katër) muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të K.Penal vihet të kryejë një punë në interes publik për 100 orë pune. Z. Erjon Noka për këtë veprë penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

DASHAMIR OCKA kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjellbër me numër rendor 07, Bashkia Devoll nuk ka deklaruar asnjë dënim të formës së prerë apo kundravajtje penale. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, me vendimin nr.114, datë 06.03.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë deklarohet fajtor për veprën penale "Drejtim të automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 të K.Penal dhe të nenit 406/1 të K.Pr.Penale dënohet me 2 (dy) muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K.Penal vihet në provë për një afat kohor prej 2 (dy) vjetësh. Z. Dashmir Ocka për këtë veprë penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

RRUSTEM GJONAJ kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjellbër me numër rendor 01, Bashkia Tropojë. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të



Nr . 538 i vendimit

Data 18.05.2017 e vendimit

Ora 12:00 e vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, me vendimin nr.48, datë 26.05.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë e ka deklaruar fajtor për veprat penale "Mbajtje pa leje të armëve zjarrit, largim nga vendi vuajtjes dënimit" e në bazë të nenit 278/2, 323, 55 të K.Penal dhe të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 3 (tre) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.238, datë 23.09.2005 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Gjykata e Lartë me vendimin nr.705, datë 24.11.2006 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Z. Rustem Gjonaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

IMER DEMAJ kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjelbër me numër rendor 09, Bashkia Tropojë nuk ka deklaruar asnjë dënim të formës së prerë apo kundravajtje penale. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, me vendimin nr.10, datë 05.03.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "Vetëgjyqësisë" parashikuar nga neni 277 të K.Penal dhe të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë gjobë. Z. Imer Demaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

LIRIM MUÇO kandidat i regjistruar në listën shumëmemërore Partia e Gjelbër me numër rendor 01, Bashkia Prrenjas ka deklaruar dënim. Sipas shkresës nr.3614 prot, dt.15.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1511/1, datë 16.05.2019, me vendimin nr.221, datë 13.04.2012 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Vjedhjes" e kryer në bashkëpunim dhe në bazë të nenit 134/2 të K.Penal dënohet me 6 (gjashtë) muaj burgim. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.10-2014-2201(495), datë 24.06.2014 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 132012(221), datë 13.04.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me këtë ndryshim: Në zbatim të nenit 59 të K.Penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burg për një afat prej prej 2 (dy) vjetësh. Z. Lirim Muço për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar germës ç, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët kryejnë me dashje një krim që nuk përfshihet në shkronjat "a" dhe "b", të kësaj pike, dhe kur janë dënuar me jo më pak se 6 muaj burgim.

Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar

.....

4. Për personat që parashikohen nga shkronja "ç", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi zgjat nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, deri në momentin e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar nenit 69 të Kodit Penal

.....

Quhen të padënuar: a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale; **b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;** c) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër



Nr . 538 i vendimit

Data 18.05.2017 e vendimit

Ora 12:00 e vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

tjetër penale; ç) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga dhjetë gjer në njëzet e pesë vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale.

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga z. Flamur Nasufi **kandidat me numër rendor 05, për anëtar këshilli i Bashkisë Gramsh**, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, "Ngacmim seksual", parashikuar nga neni 108/a/1 i Kodit Penal, nr. 384, datë 22.04.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, z. Flamur Nasufi për kryerjen e kësaj vepre penale është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksionin, kandidat për këshilltar i këshillit të bashkisë Gramsh.

Sipas parashikimeve të pikës 13 të Vendimit të Kuvendit 17.2016, KQZ pasi konstatoi se të dhënat përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga nenin 2 i ligjit 138/2015, KQZ verifikoi nëse ato përfshihen brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të ligjit nr.138/2015.

Referuar nenit 4, pika 4 për personat që parashikohen nga shkronja "c", e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat deri në rehabilitim, sipas nenit 69 të K.P.

Referuar datës së nr. 384, datë 22.04.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, nenit 69 të K.P, z. **Flamur Nasufi** përfshihet brenda periudhës së ndalimit për kandidimin në funksionin e këshilltarit të këshillit bashkiak.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturave, referuar nenit 10 pika 1, germa "a" të ligjit 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e z. **Flamur Nasufi** dhe t'i kërkoj subjektit zgjedhor Parta e Gjellbër të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave.

Për sa më sipër Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar nenit 10, pika 1, germa "a" e Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" shpall faktin se z. Flamur Nasufi është në kushtet e moszgjedhshmërisë si kandidat për anëtar Këshilli të Bashkisë Tropojë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e tjerë të shënuar në listën shumëmemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë Tropojë, Kurbin, Prrrenjas dhe Devoll, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Në këtë rast, KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillin e Bashkisë Kolonjë, Tropojë, Kurbin, Përmet, Maliq, Pogradec, Selenicë, Devoll, Ura Vajgurore, Malësi e Madhe, Gramsh, Librazhd dhe Prrrenjas, të Partisë së Gjellbër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen



Nr . 538 i vendimit

Data 18.05.2017 e vendimit

Ora 12:00 e vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

ose ushtrajnë funksione publike”, neni 5, pika 4, germa “a” i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike”; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike”.

VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Flamur Nasufi për këshillin e bashkisë Gramsh, qarku Elbasan, Partia e Gjellbër.
2. Njoftimin e Partisë së Gjellbër të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-ve, përkatëse për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillat bashkiak në bashkitë Kolonjë, Tropojë, Kurbin, Përmet, Maliq, Pogradec, Selenicë, Devoll, Ura Vajgurore, Malësi e Madhe, Gramsh, Librazhd dhe Prrenjas të Partisë së Gjellbër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 538 i vendimit Data 18.05.2017 e vendimit Ora 12:00 e vendimit

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike”